



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.05.2025, Operatori Ekonomik Marisa SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Marisa" SH.P.K., e dt.16.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 03.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Korrigjohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 03.03.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korrigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Marisa" SH.P.K., me dt.16.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pretendimi lidhur me pajisjet teknike është pjesërisht i bazuar:
 - Makine shpuese gjeotermale me sistem laserik: pjesërisht e bazuar – të largohet sistemi laserik i kontrollit dhe mbetet Makinë shpuese gjeotermale për punime-shpime horizontale dhe vertikale.
 - Traktori me krah: Pajisja e kërkuar është pajisje adekuate për natyrën e punimeve, ndërsa specifikat e saj janë kërkuar në minimum, ndërsa si auto mjet duhet patjetër të jetë i rexhistruar me librezë valide.
 - Minieskavator me peshë max 1 ton : Pajisja është në proporcion me natyrën e punimeve dhe i nevojshëm për punë
 - Gjenerator min 15 kVA: kjo pajisje është e nevojshme për realizimin e punimeve në terren.
2. Pretendimi lidhur me personelin profesional është i pabazuar:
 - Kërkesa jo e bazuar: Bazuar në përshkrimin teknik të Projekti kryesor të liqenit në lumin Erenik, – pika 5. Modelimi hidraulik i vërshimeve për liqenin dhe pendën, ceket se: "Fushat dhe hapësirat tjera përgjatë shtratit të lumit Erenik janë subjekt i përmbytjeve" për këtë arsye është kërkuar një person i certifikuar me certifikata të cekuar si në dosje të tenderit - certifikata të lëshuara nga Institucionet e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Ekonomisë.
 - Një (1) Inxhinierë i diplomuar apo master i shkencave teknike – drejtimi Mbrojtje e Ambientit – Mjedisit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit i licencuar me VNM – Vlerësimi i ndikimit në Mjedis - Ky Licencim është i nevojshëm për vlerësim të ndikimit në Mjedis;
3. Kërkesë për licencë për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit: pjesërisht e bazuar – OE duhet të jetë i pajisur me Licencë valide për prodhim zhavorri (guri ose shkëmb i fortë) ose marrëveshje për furnizim nga Operatori i licencuar.
pjesërisht e bazuar – përmirësohet kërkesa;
4. Pretendimi lidhur me ISO 50001/2018 – Sistemet për Menaxhimin e Energjisë : aprovohet si i bazuar – eliminohet ky ISO;
5. Pretendimi lidhur me kapitalin financiar është i pabazuar. Për shkak të vlerës së madhe të tenderit është e nevojshëm garancia ose Kapitali financiar i OE ofertues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

